

Fondi i ICO-së për Projekte të Veçanta

Fondi për Projekte të Veçanta (SPF), një fond i shumave të vogla i menaxhuar nga Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO) dhe i dedikuar për nisma praktike, ka dëshmuar se si mund të fuqizohen dhe promovohen dispozita të caktuara të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit (PGJS) dhe pajtimi.

Aktualisht, Fondi për Projekte të Veçanta është harxhuar dhe nuk pranon më kërkesa.

Projektet në vijim janë ose të përfunduara :

1. Ndryshimi i rrugëve në Hoçë të Madhe

Zëvendësimi i poçeve ndriçuese për ta ruajtur karakterin e një vendi me vlerë kulturore.
Organizuar nga: Komuna e Rahovecit

2. Realiteti i ri, mundësi të reja

Transmetime përmes radios në tërë Kosovën në gjuhën shqipe, serbe, turke, rome rreth decentralizimit dhe sundimit të ligjit.
Organizuar nga: NGO "Rrjeti i Radiove për të Drejtave të Njeriut"

3. Ethet e arta- Film dokumentar në Novo Bërdë

Dokumentari për Kështjellën e Novo Bërdës si zone e veçantë e mbrojtur për të edukuar shikuesit për vlerat e saj dhe për parandalimin e dëmtimit të saj të mëtutjeshëm.
Organizuar nga: Arben Llapashtica (producenti i dokumentarit)

4. Komuna jonë – mundësia jonë

Debate, seminare, shfaqje publike për decentralizimin në komunat e banuara me serbë të Kosovës.
Organizuar nga: NGO "Fractal"

5. Edukim praktik juridik për studentët e Fakultetit Juridik në Mitrovicën veriore

Edukim praktik juridik për një grup studentësh të Fakultetit Juridik nga Mitrovica veriore me qëllim që ata të ofrojnë ndihmë juridike pa para për popullatën vendore.
Organizuar nga: OJQ "Qendra për Zhvillimin e Zonave Lokale"

6. Bërja e dokumentarëve për PGJS

Transmetim televiziv i katër dokumentarëve prej 27 minutave ku përfshihen elemente nga PGJS-ja që kanë të bëjnë me të drejtat e komuniteteve.
Organizuar nga: OJQ "Qendra për Paqe dhe Tolerancë", Prishtinë

7. Decentralizimi, një rrëfim i treguar nga poshtë

Transmetim televiziv i pesë dokumentarëve prej 35-40 minutash për të informuar qytetarët e Kosovës rreth decentralizimit dhe për të vlerësuar perceptimin e tyre dhe pritjet nga ky proces. .
Organizuar nga: Bul Salihu (producent i dokumentarëve)

8. Biblioteka si pasurim

Libra të blerë për Qendrën e Dokumentimit për Romët dhe Ashkalitë që lidhen me të drejtat e komuniteteve, çështje gjinore dhe zhvillimore me qëllim që shoqëria civile të informohet në lidhje me të drejtat e tyre dhe që të dinë si të parandalohen rastet e diskriminimit.

Organizuar nga: OJQ "Qendra e Dokumentimit për Romë dhe Ashkali" (QDRA), Prishtinë

9. Trekëndëshi

Produksion i 26 programeve një-orëshe në radio rreth decentralizimit në Radio KIM. Programet janë fokusuar në aspektet teknike të decentralizimit.

Organizuar nga: Radio KIM, Çagllavicë

10. Kampi veror shumetnik

Një javë kamp veror në Brezovicë me një sërë seminaresh (të drejtat e njeriut, të drejtat e komuniteteve, diversiteti, paqja, bashkëjetesa dhe pajtimi), aktivitete arsimore dhe argëtuese, lojëra sportive për 45 nxënës mes moshave 14 dhe 16 nga komuna e Obiliqit duke përfaqësuar komunitete të ndryshme (25 shqiptarë, 9 serbë, 2 boshnjakë, 6 romë, 3 ashkali).

Organizuar nga: OJQ "Shoqata e Grave AUREOLA"

11. Vala informative

Lansimi i radio stacionit (Info wave/Vala informative) që fokusohet në problemet ditore të popullatës që jeton në enklavat e Prelluzhës (shoqëria civile, punësimi, institucionet publike, të drejtat e komuniteteve, siguria në rrugë, rryma, shëndetësia etj).

Organizuar nga: OJQ "DUGA"

12. Ndërtimi i basenit të ujit në shat për ujë të pijshëm

Ndërtimi i një baseni për furnizim me ujë të pijshëm për fshatin e Pllanjanit, i banuar nga komuniteti serb e boshnjak. Synimi i projektit është promovimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe parandalimi i konflikteve në mes atyre dy komuniteteve që kanë jetuar në marrëdhënie të mirë me vite të tëra.

Organizuar nga: Këshilli për furnizim me ujë I Pllanjanit

13. Ndërtimi i rrugës me kalldrëm në lagjen Kodra (Gelancë)

Shtrimi i rrugës me kalldrëm për të lidhur lagjen Kodra, që kryesisht banohet me ashkali, me fshatin Gelancë që kryesisht banohet nga shqiptarët.

Organizuar nga: Komuna e Suharekës

14. Kampi arkeologjik për rininë ndëretnike – Ulpiana 2009

Një kamp dyjavor arkeologjik për 18 nxënës të shkollave të mesme (4 serbë, 3 romë dhe shkali dhe 11 shqiptarë) në zonën e Ulpianës (Graçanicë). Qëllimi ka qenë të sensibilizohet rinia e Kosovës me vlerat e trashëgimisë kulturore dhe historike përmes ligjëratave, mësimeve në terren, trajnimit praktik dhe projekteve multi-mediale.

Organizuar nga: Muzeu i Kosovës

15. Konferencë – Politikat vendore në shoqëritë shumetnike

Më 10 shtator, në Prishtinë është organizuar një konferencë për të prezantuar rezultatet e e hulumtimit të bërë për të drejtat e komuniteteve në tri komuna (Obiliq, Gjilan dhe Prizren) së bashku me rekomandimet për qeverisjet lokale dhe qendrore.

Organizuar nga: OJQ "KHCS Shoqata Nënë Tereza"

16. Uji nga ujësjellësi për secilën familje në Pasjan

Sjellja e ujit të ujësjellësit në secilën prej 400 familjeve që jetojnë në fshatin serb Pasjan (me rreth 2000 banorë). Përveç komunës së Gjilanit dhe FVP-së për këtë projekt ka kontribuar edhe çdo familje.

Organizimi: Komuna e Gjilanit

17. Ndhimoje veten dhe komunitetin

Për një periudhë prej tre muajsh, janë organizuar manifestime publike (p.sh. koncerte), të organizuara në radhë të parë për të informuar komunitetin romë, ashkali dhe egjiptianë (RAE) rreth PGJS-së dhe për të promovuar të drejtat e komuniteti në rajonet e Prishtinës dhe Mitrovicës.

Organizuar nga: OJQ "Romano Anglunipe", OJQ "Romane Gjuvlja ko Angluno Veko" dhe OJQ "Romano Resaibe"

18. Lundruesit ndërkulturor – takimi i serbëve në Supetar të Kroacisë

Dymbëdhjetë të rinj serbë nga Kosova u takuan më 14-18 tetor 2009 me serbët e Kroacisë për të diskutuar rreth të mirave që sjell integrimi i pakicave.

Organizuar nga: Këshilli Britanik nga Kroacia

19. Kremtimi i trashëgimisë kulturore në Kosovë

Gjatë një periudhe njëmuajore, me rastin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, u organizua një konkurs i pikturimit në temën "perceptimi i trashëgimisë kulturore në Kosovë" ku morën pjesë 360 të rinjë nga komunitetet shumetnike rurale, të cilët janë pjesë e projektit "Fëmijët për Paqe", të mbledhur në 16 klube nga mbarë Kosova.

Organizuar nga: OJQ "World Vision Kosovo", zyra në Prishtinë

20. Simpoziumi DTE në Vushtrri – Roli i hamamit gjatë historisë

Në kuadër të Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, u organizua një simpozium në Vushtrri i pasuar me vizita në monumentet që zakonisht janë të mbyllura për qytetarët, siç janë hamami i Vushtrrisë, "Ura e Gurit" dhe Kalaja e Vushtrrisë.

Organizuar nga: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Qeverisë së Kosovës

21. Ditët e Trashëgimisë Evropiane 2009 në Kosovë

Gjatë një periudhe prej një muaji është organizuar tregu me prodhime artizanale në Prishtinë dhe një panair artizanal në Novobërdë, në të cilin gratë e komuniteteve të ndryshme i paraqitën punimet e tyre të dorës. Ky projekt i filluar para pesë vitesh në Prishtinë ka për qëllim që të përmirësojë marrëdhëniet ndëretnike dhe të promovojë trashëgiminë kulturore të Kosovës.

Organizuar nga: OJQ "Dera e Hapur"

22. Punimet e dorës promovojnë trashëgiminë kulturore të Hoçës së Madhe

Dy grupe prej 25 grave serbe të Kosovës u trajnuan në qepje, qëndisje, për të punuar në endës dhe për bazat e TI-së, që ato të aftësohen për të krijuar punime të ndryshme dore duke pasur parasysh ekspozitën që ishte mbajtur më 12 tetor 2009 me rastin e festivalit të verës në Hoçë të Madhe.

Organizuar nga: OJQ "Jefimija"

23. Tabelat me informata për monumentet e trashëgimisë kulturore në Prizren

Janë ndërtuar dhjetë tabela me informata dhe janë vendosur në vendet strategjike që qojnë drejt qendrës historike të Prizrenit. Qëllimi i këtyre tabelave ishte për të paraqitur lokalitetet e trashëgimisë kulturore me hartë dhe me përshkrim narrativ për të orientuar vizitorët.

Organizuar nga: Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Prizren

24. Zëvendësimi i punimeve të marangozit në objektin e shkollës

Zëvendësimi i punimeve të vjetra të marangozit në shkollën fillore dhe të mesme të ulët "Izvor" ku vijojnë shkollimin 350 nxënës boshnjakë në fshatin Lubinjë e Epërme.

Organizuar nga: Shkolla fillore dhe e mesme e ulët "IZVOR"

25. Ditët e trashëgimisë kulturore në rajonin e Pejës

Me rastin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane, në shkolla u zhvilluan ligjërata për trashëgiminë fetare dhe kulturore, u mbajtën debate me qytetarët, u vizituan monumentet e rëndësishme dhe vendet historike si dhe u organizuan ekspozita me fotografi të vjetra, prodhime të kuzhinës tradicionale, punime të dorës dhe kostume popullore.

Organizuar nga: Komuna e Pejës

26. Fshati i lidhur me botën (ende vazhdon)

Hapja e një internet kafeneje pa pagesë për banorët e Debelldes, për përmirësimin e aftësive për kompjuterë në zonat më pak të zhvilluara, si dhe për të ndihmuar të rinjtë e fshatit në shkollim dhe që të krijojnë lidhje me të rinjtë e tjerë në rajon dhe në botë. Projekti po ashtu ka për qëllim forcimin e lidhjeve në mes të banorëve të rajonit dhe në konsolidimin e marrëveshjes për demarkacionin e kufirit.

Organizuar nga: OJQ "Kosovo Center for International Cooperation"

27. Radio Bravo (ende vazhdon)

Hapja e radiostacionit të parë - *Radio BRAVO* – në vendbanimin e të kthyerve serbë në Osojan (Komuna Istogut) në një rajon i cili mbetet enklava më e padepërtueshme dhe më e izoluar në rajonin e Pejës pas hapjes së kohëve të fundit të enklavës së Gorazhdecit. Ky projekt ua mundëson banorëve që të kenë qasje në informata të llojllojshme nga bota jashtë kësaj enklave.

Organizuar nga: OJQ "Agro Focus"

28. Edhe në ekzistojmë

Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive për festimin e Ditës së Romëve (6 prill) në komunën e Graçanicës si dhe në rajonin e Prishtinës nga data 5 deri më 11 prill 2010.

Organizuar nga: OJQ "Sytë e së Ardhmes"

29. Mbështetja e arsimit shumetnik në komunën e Vitisë: Renovimi i Shkollës Fillore "Ndre Mjeda" në Binçë (ende vazhdon)

Përmes këtij projekti janë adresuar nevojat e ndryshme në dy objekte shkollore në të njëjtin oborr në fshatin Bincë. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i infrastrukturës dhe cilësisë së shkollimit në këtë shkollë në komunën e Vitisë.

Organizuar nga: Komuna e Vitisë

30. Mbështetja e arsimit shumetnik në komunat e Kamenicës dhe Ranillugut (ende vazhdon)

Projekti fokusohet në infrastrukturë si nevojë më themelore dhe imediate, si dhe në pajisjet e TIsë – të cilat mund të shërbejnë si platformë për projekte të tjera shumetnike në të ardhmen.

Organizuar nga: Komuna e Kamenicës.